



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

01 - 04 Janar 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Sulmohet fizikisht një peditër në spitalin e Tetovës

Tetovë, 3 janar- Një mjek kujdestar në Spitalin Klinik në Tetovë, në pediatri, fizikisht është sulmuar dhe në orën 15 e 20 min nga ana e njëzet e pesë vjetarit N.S. nga fshati Shemshovë i cili së bashku me dy persona të panjohur të gjinisë femërore dhe një fëmijë janë futur në ordinancën për dhënien e ndihmës mjekësore për fëmijën, transmeton zhurnal.mk

Ministria e punëve të brendshme informoi se mjeku pasi që e ka pa raportin mjekësor nga Kirurgjia dhe ka kërkuar që t'i sjellin udhëzimin, personi iu është drejtuar dhe fizikisht e ka sulmuar, dhe pastaj ka nisur me duar që ta sulmoje byronë e punës, kompjuterin dhe mjetet tjera të cilat i ka shpërndarë nëpër tokë, për të cilin mjeku përmes motrës kujdestare Q.J.(46) ka kërkuar që të thirret sigurimi, dhe pasi që e njëjta ka tentuar për ta thirrur sigurimin, personi edhe atë e ka sulmuar fizikisht dhe ka ikur nga vendngjarja.

Pas masave të ndërmarra u vërtetua identiteti i personit. Bëhet fjalë për N.S.(25) nga fshati Shemshovë. SPB Tetovë po punon për zbardhjen e tërësishme të rastit.

Maqedonija lider në rajon për rritjen e natalitetit, por meritat shkojnë tek popullata shqiptare

Shkup, 2 janar – Derisa shtetet e tjera të Ballkanit shënojnë ulje të natalitetit, Maqedonia vitin e kaluar shënoi rritje. Gjendja alarmante paraqitet sidomos në Kroaci. Demografi Sjepan Shterc në lajmet e HRT-së pohoi se rënia e natalitetit dhe largimi i të rinjve nga Kroacia, janë ndër problemet kryesore të këtij shtetit. Ai paralajmëroi se sivjet pritet që në Kroaci nataliteti të shënon ulje madje për 20 %.

Derisa shtetet fqinje kanë pasojën e zvogëlimit të natalitetit, në Maqedoni viteve të fundit shënohet trend pozitiv.

Mediat proqeveritare në Maqedoni, rritjen e natalitetit e përshkruajnë si meritë e qeverisë dhe projektit për fëmijën e tretë.

Këto media thonë se qeveria e Maqedonisë demografinë e ka vënë në prioritet të lartë për ardhmërinë e shtetit. Duke krahasuar statistikën e 55 viteve të kaluara, numri i lindjeve për grua është zvogëluar në 63 %. Televizioni Sital raporton se masat qeveritare që filluan të zbatohen nga viti 2008, po japin rezultate.

Sipas televizionit, pikërisht lindjen e rasteve me tre fëmijë e mban natalitetin dhe e rrisin fertilitetin në vend.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



"Në Maqedoni, gjatë vitit 2008 lindën 22.945 bebe, nga të cilat 2677 fëmijë i tretë. Gjatë vitit 2014 kanë lindur 23.674 nga të cilët 3715 si fëmijë i tretë në familje. Rritja e fëmijëve të tretë të lindur brenda kohës ka shkuar në 1038 brenda 7 vitesh, ose me përqindje 39. Maqedonia është rast suksesi dhe shembull për shtetet fqinje", njoftoi Sitel.

Por duhet theksuar se nataliteti në Maqedoni është në rritje të vazhdueshme dhe vetëm në pesë vitet e fundit lindjet janë shtuar për 3.3 për qind, por rritja u përshkruhet vendbanimeve shqiptare të Maqedonisë veriperëndimore.

Në vitin 2008 popullata shqiptare ka marrë pjesë me 31.8 për qind, në numrin e përgjithshëm të lindjeve ndërsa në vitin e kaluar kjo përqindje ka qenë 35.1 për qind.

Enti i Statistikave të Maqedonisë në raportin e publikuar për gjysmën e parë të vitit 2015. thotë se komunat me më së shumti natalitet janë: Tetova, Çairi, Kumanova, Saraji, Studeniçani, Struga, Shuto Orizarja, Bogovina, ndërkaq, komunat me natalitet të ulët janë: Manastiri, Karposhi, Prilepi, Velesi, Koçani, Ohri, Kisella Voda, Kërçova, Demir Hisari dhe disa qytete të tjera të Maqedonisë lindore dhe qendrore.

Alarmimi i situatës për natalitetin bëhet tani, kur edhe pritet që Qeveria të publikojë Strategjinë për shtimin e popullsisë, të cilin vitin e kaluar e përgatiti Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" me kërkesë të Qeverisë. Sipas të njëjtave statistika, lindjet nga etnia maqedonase kanë rënë nën 50 për qind, për rreth 60-të vjet.

Sipas Entit Shtetëror për Statistika, më 2013-të kanë lindur 11.602 maqedonas, 7.488 shqiptarë, 1.088 turq dhe 1.226 romë. Nga këto lindje shihet se vetëm për 5 vjetët e fundit ka një rënie rreth 5 për qind e lindjeve tek maqedonasit, transmeton Zhurnal.

VIDEO: Rritet numri i meshkujve që përdorin pushimin e lindjes

Shkup, 2 janar - Këtë vit është rritur numri i meshkujve të cilët kanë vendosur që në vend të nënës, ata ta përdorin pushimin e lindjes për t'u kujdesur për foshnjën, ndërsa nënat të kthehen në punë. Megjithatë, numri i tyre që e kanë marrë këtë hap, në krahasim me vendet e tjera evropiane është minimal, njofton 21.

"Numri i burrave të këtyllë është relativisht i vogël. Ne kemi evidencë nga viti 2012. Çdo vit, numri po ndryshohet nga 19 deri në 28 persona dhe në vitin 2015 ka pasur 28 burra të tillë. Ky është një trend që ekziston në gjithë Maqedoninë, por shumica e burrave që përdorin pushimin e lindjes, mesatarisht në Shkup janë nga 10 deri në 12. Në qytetet e tjera janë nga një ose dy, ndërsa në disa qytete nuk ka fare", thotë Drejtori i Fondit për Sigurim Shëndetësor, Orhan Ramadani.

Sipas Ramadanit, duke filluar nga viti 2012, kur Fondi për shëndetësi ka filluar t'i evidentojë meshkujt që e marrin pushimin e lindjes deri në vitin 2015, atë e kanë shfrytëzuar 77 meshkuj.

Sipas Fondit për Sigurim Shëndetësor, në shumicën e rasteve, gratë pushimin e lindjes e kanë një ose dy muaj, dhe pastaj ua japin burrave. Bëhet fjalë për gra ambicioze, që shpejtojnë të kthehen në punë ose për gra që frikohen për vendin e tyre të punës. Sipas Ligjit, babai i fëmijës mund ta marrë pushimin e lindjes, por



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



sociologët theksojnë se burrat ndjehen të rehatshëm kur gratë e kryejnë gjithë punën edhe në shtëpi, por edhe rreth fëmijës.

“Mentaliteti nuk është një kategori e veçantë, nuk është traditë, por thjesht, këtu bëhet fjalë për konformizëm. Pse unë të bëj diçka kur mund ta bëjë gruaja. Gruaja nuk i ka ato mekanizma që ta detyrojë burrin të gatujë, t'i kryejë punët e shtëpisë dhe në të njëjtën kohë ta ketë punën e vet. Kjo nuk del aq nga tradita, sa është rezultat i një komformizmi të psikologjisë mashkullore, që të fitoni diçka me pak punë dhe të ndjehemi mirë”, thekson sociologu, Ilija Acevski.

Acevski shton se, në vendet e tjera evropiane në të cilat burrat në vend të grave e përdorin pushimin e lindjes, këtë e bëjnë sepse janë racionalë dhe të arsyeshëm. Ata janë liruar nga paragjykimet se larja e rrobave, gatimi dhe kujdesi për fëmijët janë punë vetëm për gratë.

Në Maqedoni, burrat janë me mendime të ndara për atë se a do ta merrnin pushimin e lindjes në vend të gruas. Disa shprehen se janë për, ndërsa të tjerë thonë se kjo është punë e grave.

Burrat kanë të drejtë ta marrin pushimin e lindjes në vend të grave, ndërsa gruaja t'i kthehet punës së saj. Ju a do ta kishit bërë një gjë të tillë, pra ta merrni pushimin e lindjes në vend të gruas?

„Jo, gruaja duhet ta marrë.”

„Pse jo. Mendoj se kjo është e barabartë. Sa ka të drejtë gruaja mbi fëmijën, po aq ka edhe burri.”

„Po, po.”

„Jo, jo, nuk do ta merrja. Kjo është e drejta e saj.”, shprehen burrat në anketën e bërë nga TV21.

Ndryshe, sipas ligjit, të drejtën për pushim të paguar e kanë ose nëna ose babai, me kompensim për 9 muaj, në vlerë varësisht pagës së përdoruesit të pushimit të lindjes.

Nëse babai dëshiron ta përdorë të drejtën e pushimit të lindjes, në Fondin e Shëndetësisë duhet të paraqesë certifikatë lindjeje për fëmijën dhe vërtetim se nëna po kthehet në punë.

Sipas ligjit, nëna nuk mund të kthehet në punë brenda 45 ditëve pas lindjes. Kur të kthehet në punë, atëherë gruaja ka të drejtë për një pauzë të paguar për ta ushqyer me gji fëmijën, për një periudhë prej 1.5 orësh në ditë, dhe kjo dukuri zgjat derisa fëmija nuk mbush një vit.

Më shumë para për stomatologët amë, paga më të mëdha për specialistët

Shkup, 2 janar- Nisi rritja për pesë denar e participimit për stomatologët, gjegjësisht nga 35 denar në 40 denar, transmeton zhurnal.mk



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Me këtë masë të Fondit për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë, për rritjen prej 14 përqind janë të përfshirë rreth 1146 ekipe të stomatologëve që punojnë në 963 ordinanca.

Mjetet janë të siguruara nga buxheti i Fondit për këtë vit, ndërsa implikimi fiskal në pjesën e rritjes së participimit për stomatologët do të jetë 75.3 milion denar në nivel vjetor.

Ky participim për stomatologët amë nuk është rritur prej më shumë se shtatë viteve.

Përsëri rritjes së participimit për stomatologët, nis rritja e participimit për njëzet përqind të pagave për specialistët nga Qendra e Klinikës Stomatologjike.

Nga një qershori për pesë denar do të rritet edhe participimi për mjekët amë, gjegjësisht nga 50 do të bëhet 55 denar. Me këtë rritje do të përfshihen 1.085 shtëpi private të shëndetit me gjithsejtë 1.527 ekipe.

Në Tetovë fëmija i parë vajzë, Teuta e shpërblen me 40 mijë denarë

Shkup, 1 janar – Kryetarja e komunës së Tetovës znj. Teuta Arifi ka ndarë 40 mijë denarë për Poemën, fëmijën që ka lindur pas mesnate në Tetovë.

“Ashtu si tradicionalisht edhe këtë vit vizitova Qendrën Klinike të Tetovës, për të shpërblyer fëmijën e parë të lindur me ndërrimin e motmoteve”, është shprehur kryetarja Arifi, njofton Zhurnal.

“Çifti Petrit Neziri dhe Vjollca Skenderi-Neziri, ishte familja që Zoti i kishte bekuar me vajzën e emërtuar Poema, e lindur në orën 01:05 me peshë 3110 gram dhe gjatësi 50 cm. Voglushja lindi me operacion cezarian dhe në gjendje të mirë shëndetsore. Shumë lumturi dhe jetëgjatësi për Poemën”.

Pas letrës të dërguar në Zhurnal, qëndron person i policisë(!)



Shkup, 31 dhjetor –Pas publikimit të një letre që na arriti në Agjencinë e Lajmeve Zhurnal në lidhje me marrjen “ryshfet” në Ish Spitalin Ushtarak në Shkup, para disa castesh arriti edhe një letër tjetër nga i njëjti person.

Në letër mes tjerash thuhet se ka prova të fuqishme (video-xhirime) nga disa mjekë maqedonas dhe shqiptar të cilët marin ryshfet në ish Spitalin Ushtarak në Shkup.

Përfshir këtu edhe personel ndihmës si motra medicinale, teknik medicinal dhe transportues të pacientëve.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Njëri nga personeli ndihmës është shqiptar nga një fshat i Shkupit i cili bashkëpunon me mjekët maqedonas ku përmes dhënies së "ryshfetit" ju kryen shërbime spitalore në repartin e Internës dhe Kirurgjisë.

Ndërsa mjekët janë nga qytetet e ndryshme të Maqedonisë.

Dërguesi i letrës shkruan se punon në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ka video-xhirime që janë bërë gjatë tre viteve të fundit se si pacientët kanë dhënë ryshfet të mjekët e Spitalit "8-Shtatori" në Shkup.

Ka video xhirime se si mjekët në ish spitalin ushtarak në Shkup marrin "ryshfet" nga pacientët!

Shkup, 31 dhjetor – Tronditet ish spitali ushtarak në Shkup nga një letër e cila ka arritur në Zhurnal ku shkruhen me detale se si është i organizuar "ryshfeti" nga ana e mjekëve dhe personelit tjetër ndihmës. Sipas kësaj letrë, jo vetëm për disa mjek por edhe personel tjetër ndihmës marrin "ryshfet" nga pacientët e Maqedonisë dhe Kosovës.

Sipas kësaj letrë pretendohet se ky rast i marrjes së "ryshfetit", ndjeket me kujdes të veçant nga organet përkatëse të Maqedonisë.

"Me vite merren masat operative ndaj disa mjekëve dhe personelit tjetër të cilët marrin "ryshfet". Masat operative ndaj tyre po merren me vite, ka edhe video xhirime ku shifet qartë se si kanë marrur ryshfet. Disa i kanë marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë e disa përmes ndërmjetësve. Nga dëshmit është e qartë se si mjekët kanë marrë tarifa të ndryshme, diku 200-300 euro, e ndërsa diku 500 deri më 3000 mijë euro.

Këto dëshmi hetohen dhe bëhen planet operative për të vepruar që sa më shpejt organet e ndjekjes ti arrestojnë shkelësit e ligjit", shkruhet mes tjerash në letrën që ka arritur në Zhurnal.

Sipas kësaj letrë një person shqiptarë në bashkëpunim me mjek maqedonas ka arritur për një vit vetëm nga "ryshfeti" të sigurojë me mijëra euro. Personi është i Shkupit dhe është i punësuar në spital dhe ai fillimisht i regruton pacientët të cilës dëshirojnë të operohen apo të qëndrojnë në spital për shërim.

"Skema është e qartë, personi me urdhër të mjekëve maqedonas i kapë pacientët shqiptarë dhe ju kërkon tarife të ndryshme për operim apo qëndrim në spital. Ju kërkohet pacientëve tarifa të ndryshme 200, 300, 500 dhe 1000 ose më shumë euro. Madje pacientët kosovarë paguajn shuma marramendëse, ku të gjithë këto para ndahen mes mjekëve maqedonas dhe ndërmjetësit", shkruhet mes tjerash në letrën që ka arritur në Zhurnal.

Sipas kësaj letrë më tronditëse është situata me kirurgët dhe personelin ndihmës në spitalin "8 shtatori", të cilët me vite marrin "ryshfet" nga pacientët. Edhe kjo është e dokumentuar.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk




Në Shkup kanë lindur 10 mijë fëmijë

Shkup, 31 dhjetor – Rreth 10.600 fëmijë kanë lindur në spitalet shtetërore dhe ato private që në fillim të këtij viti. Klinika e gjinekologjisë dhe akusherisë ka përfundur vitin me 6 mijë lindje. Në vend të dytë për nga numri i lindjeve është klinika Nënë Tereza në Cair me 2.979 fëmijë të lindur prej tyre 1.526 femra dhe 1.453 meshkuj, njofton Zhurnal.

Gjinekologët thonë se rreth 3 mijë lindje kanë ndodhur në klinikën e Cairit dhe shumë të tjera në spitalin klinik shtetërorë. Në klinikat private më së shumti kanë lindur në Sistina rreth 1 mijë fëmijë. 630 të tjera në Remedikka. Sipas të dhënave nga enti statistikorë në 2014 ka pasur 23.767 lindje në gjithë Maqedoninë.



Në "Alo doktor" për një javë 1.322 thirrje



Në linjën telefonike 02/15 123 për këshillë mjekësore "Alo doktor" gjatë shtatë ditëve të kaluara ka pasur 1.322 thirrje...

Shtëpia e Shëndetit Shkup njoftoi se nga 15 shtatori i vitit 2014 kur filloi të punojë linja, deri më tani, ka pasur 69.560 thirrje.

Linja është e hapur çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim i drejtëprëndrejtë mjekësor në momentin e paraqitjes së sptomave të ndryshme të çrregullimit të shëndetit.

Njëzetë e pesë mjekë janë në dispozicion për këshillë mjekësore. Thirrjet janë nga qytetarë nga të gjithë qytetet e Maqedonisë.

Paraqitjet janë për spektër të gjërë të simptomatologjisë më të ndryshme, më së shpeshti për simptome respiratore, temperaturë të rritur trupi, ftohje dhe kollitje të shkaktuara nga moti i ftohtë.

Të gjithë atyre personave të cilët kanë kërkuar këshillë mjekësore në linjën telefonike "Alo doktor" u është dhënë ndihmë shëndetësore me këshillë dhe terapi adekuate simptomatike./Mia



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Stomatologët, rritje për pesë denarë e pikëve për kokë banori



Fillon rritja për pesë denarë e pikëve për kokë banori të stomatologëve, gjegjësisht prej 35 në 40 denarë...

Me këtë masë të Fondit për sigurim shëndetësor të Maqedonisë për rritjen e pikëve për kokë banori prej 14 për qind janë përfshirë rreth 1.146 ekipe të stomatologëve, të cilët punojnë në 963 ordinanca.

Mjetet janë siguruar nga buxheti i Fondit për këtë vit, ndërsa implikimi fiskal në pjesën e rritjes së pikëve për stomatologët

do të jetë 75,3 milionë denarë në vit. Fondi do të paguajë 599,3 miliojnë denarë në vit për stomatologët amë. Rritje e pikëve për dentistët amë nuk ka pasur për më shumë se shtatë vite. Krahas rritjes së pikëve të dentistëve, fillon edhe rritja për 20 për qind e pagave të specialistëve nga Qendra klinike e stomatologjisë. Nga 1 korriku këtë vit për pesë denarë do të rriten edhe pikat për kokë banori të mjekëve amë, gjegjësisht prej 50 në 55 denarë.

Me këtë rritje do të përfshihen 1.085 institucione private shëndetësore me gjithsej 1.527 ekipe. Rritja e fundit e pikëve në pjesën e mjekëve amë ishte në vitin 2011. Me rritjen e pikëve të dentistëve dhe mjekëve amë janë përfshirë mbi 2.800 mjekë.

Tre foshnje të lindura 1 minutë pas mesnatës; viti 2016, vit i begatshëm



Tre foshnje të lindura në klinikën gjinekologjike në Shkup vetëm 1 minut pas mesnatës, dy të gjinisë mashkullore dhe një e gjinisë femërore...

Një foshnje e gjinisë mashkullore është fëmija i tretë i familjes derisa dy të tjerë mashkull dhe femër janë binjak dhe janë fëmijë të parë të çiftit. Ministri i shëndetësisë Nikolla Todorov dhe Krzetari I qytetit të Shkupit vizituan foshnjat e para të lindura 1 minutë pas mesnatës.

“Të jetë një vit I lumtur dhe I bëgatë për të gjithë ne, për gjithë vendin për gjithë qytetarët. Ky vit filloi me 3



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



foshnje 2 binjak dhe me 1 fëmijë i cili është i treti me rradhe në këtë familje ne shohim se ky vit do të jetë i begatshëm", shprehet ministri i shëndetësisë Nikolla Todorov.

Ndërsa qyteti i Shkupit ju ka ndarë nga 20 mijë denarë foshnjave të para të lindura 1 minutë pasmesnatës.

"Shihet qartë se ky vitë do të jetë i begatshëm në minutën e parë kemi 3 foshnje dhe shpresojmë që në vitin 2016 do të ketë më shumë foshnje të lindura në krahasim nga viti i kaluar", shprehet kryetari i qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

Aleksandra Andanova nëna e binjakëve shprehet se këtë momentë e ka pritur plot 8 vite.

"Ndjem e emocionuar dhe e lumtur. Ndjenja është e mrekullueshme. Kjo është shtatëzania ime e pare me in vitro, të cilën 8 vite e kam pritur", shprehet nëna e binjakëve Aleksandra Andova.

Ndërsa drejtoresha e klinikës gjinekologjike theksoi se vitin 2015 kanë lindur 6000 foshnje.



Në "Alo doktor" për një javë 1.322 thirrje



Në linjën telefonike 02/15 123 për këshillë mjekësore "Alo doktor" gjatë shtatë ditëve të kaluara ka pasur 1.322 thirrje.

Shtëpia e Shëndetit Shkup njoftoi se nga 15 shtatori i vitit 2014 kur filloi të punojë linja, deri më tani, ka pasur 69.560 thirrje.

Linja është e hapur çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim i drejtëprdrejtë mjekësor në momentin e paraqitjes së shtomave të ndryshme të çrregullimit të shëndetit.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Njëzetë e pesë mjekë janë në dispozicion për këshillë mjekësore. Thirrjet janë nga qytetarë nga të gjithë qytetet e Maqedonisë.

Paraqitjet janë për spektër të gjërë të simptomatologjisë më të ndryshme, më së shpeshti për simptome respiratore, temperaturë të rritur trupi, ftohje dhe kollitje të shkaktuara nga moti i ftohtë.

Të gjithë atyre personave të cilët kanë kërkuar këshillë mjekësore në linjën telefonike "Alo doktor" u është dhënë ndihmë shëndetësore me këshillë dhe terapi adekuate simptomatike.



Në "Alo doktor" për një javë 1.322 thirrje



Shtëpia e Shëndetit Shkup njoftoi se nga 15 shtatori i vitit 2014 kur filloi të punojë linja, deri më tani, ka pasur 69.560 thirrje.

Linja është e hapur çdo ditë 24 orë me qëllim që të mundësohet konsultim i drejtëprëndrejtë mjekësor në momentin e paraqitjes së sptomave të ndryshme të çrregullimit të shëndetit.

Njëzetë e pesë mjekë janë në dispozicion për këshillë mjekësore. Thirrjet janë nga qytetarë nga të gjithë qytetet e Maqedonisë.

Paraqitjet janë për spektër të gjërë të simptomatologjisë më të ndryshme, më së shpeshti për simptome respiratore, temperaturë të rritur trupi, ftohje dhe kollitje të shkaktuara nga moti i ftohtë.

Të gjithë atyre personave të cilët kanë kërkuar këshillë mjekësore në linjën telefonike "Alo doktor" u është dhënë ndihmë shëndetësore me këshillë dhe terapi adekuate simptomatike.